

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-042/2015

**Prishtinë
12 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

B. (M) S.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/220/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA06331) i datës 27 nëntor 2013, pas seancës së mbajtur me 12 Tetor 2016 morri këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. (M.) S. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA06331.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/220/2013 i datës 27 nëntor 2013 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA06331.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 10 Janar 2007, B.S, ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) në cilësinë e titullarit të së drejtës pronësore ku kërkon ri posedimin ndaj ngastrës nr. 4455, me kulturë kullosë që gjendet në zonën kadastrale të Gjakovës vendi i quajtur Sade Qerim me sipërfaqe 04.27.62 ha (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar).
2. S. thekson se të drejtën pronësore nuk mund ta ushtrojë për shkak të rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99 ku përmend datën 13 qershor 1999 si datë të humbjes dhe se prona e kërkuar është e uzurpuar nga T. G..
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Fletën poseduese Nr.2259 të lëshuar nga Enti i Gjeodezisë dhe Shërbimit Kadastral në Komunën e Gjakovës me datën 7 Tetor 1997. S. figuron të jetë bashkëpronarë i pronës së kërkuar. Bashkëpronarë tjerë janë Kombinatit Bujqësorë Industrial “Ereniku” nga Gjakova dhe dy persona tjerë.
 - Procesverbalin e datës 16 shkurt 1998 nga ujdia gjyqësore në Gjykatën Komunale të Krushevcit.
 - Aktvendimin Nr. 952-01-98-53-C të lëshuar nga Enti i Gjeodezisë dhe Shërbimit Kadastral në Komunën e Gjakovës me datën 17 Shkurt 1998 përmes të cilit u aprovua kërkesa për regjistrim në kadstër të pjese ideale 1/3 të pronës së kërkuar në emër të B.S., gjithnjë pas marrëveshjes gjyqësore lidhur me masën trashëgimore të M. S..

4. Sipas raportit të verifikimit të datës 21 dhjetor 2010, prona e kërkuar ishte ndarë në tri ngastra dhe e njëjta ishte shitur në bazë të Kontratës për blerje Vr. Nr. 273/2007 të datës 29 janar 2007.
5. Identifikimi i pronës së kërkuar ishte bërë më 10 korrik 2007. Prona nuk ishte e uzurpuar. Më 30 korrik 2010, AKP-ja bëri ri-identifikimin e pronës, duke e publikuar në Gazetën për Njoftim nr. 6 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-it. Të njëjtat publikime janë lënë edhe në Gjykatën Komunale në Gjakovë, Zyrën Kadastrale, Komunën e Gjakovës, Zyrën Regjionale në Pejë, Ombudspersoni, EULEX etj.
6. Me 27 Nëntor 2013, me vendimin e tij KPCC/D/A/220/2013 Komisioni e hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. KKPK-ja në arsyetimin e vendimit thekson se paraqitësi i kërkesës fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posedimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe kërtimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se prona është humbur si pasojë e tjetërsimit vullnetar përmes shitjes.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 6 qershor 2014. B. S. pranoi vendimin e KKPK-së përmes djalit të tij të moshës madhore M. S.(afërsinë familjare me paraqitësin e kërkesës e dëshmoi në Agjenci me Certifikatën e lindjes të datës 31.01.2014)
8. Paraqitësi e kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë më 1 gusht 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala ankuese pretendon se ai ka humbur posedimin si pasojë e braktisjes së pavullnetshme të pronës dhe se kërkon kthimin e posedimit ndaj pronës së kërkuar. Me të marrë informacione nga AKP-ja se prona është tjetërsuar përmes shitblerjes, fillimisht ai e ka pohuar se i ka dhënë autorizim avokatit T. B. dhe i njëjti ka vepruar në emër të tij, por më vonë ai mohon të ketë dhënë autorizim mirëpo nuk paraqet asnjë dokument shtesë për ta mbështetur pretendimin e tij.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Gjykata Supreme e Kosovës vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se:
- Gjykata pranon arsyeshmerinë e vonesës përtej 30 ditëve por konstaton se ankesa është e pa bazuar.**
11. Neni 12.1 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh me sa vijon: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të paraqes ankesë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”.*
12. Palës ankuese i është dorëzuar vendimi më 6 Qershor 2014. Ai ka paraqitur ankesën e tij më 1 Gusht 2014.
13. Dorëzimi i vendimit të Komisionit tek pala ankuese ishte bërë në përputhje me nenin 111.1 të LPK-së që parasheh mundësinë e dorëzimit të shkresave anëtarit të familjes të moshës madhore.
14. Pala ankuese ka kërkuar që t’i mundësohet shqyrtimi i ankesës edhe pse e ka humbur afatin ligjor prej 30 ditësh duke e cekur në ankesë se arsyeja e vonesës është sëmundja dhe trajtimi mjekësor në Institucionet përkatëse shëndetësore.
15. Për të mbështetur pretendimin tij për pamundësinë e parashtrimit të ankesës ka bashkangjitur dokumentacionet mjekësore:
- Flete lëshimin e datës 09 korrik 2014 Spitali i Përgjithshëm në Krushevc.
 - Flete lëshim nga Instituti i sëmundjeve kardiovaskulare “Dedinje” Beograd
16. Gjykata gjeti se kërkesa e palës ankuese për kthim në gjendje të mëparshme është në përputhje me nenin 129.1 të LPK-së që parasheh se “Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.
17. Neni 7.4 i Urdhëresës administrative nr. 2007/05 për zbatimin e rregullores nr. 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën

bujqësore dhe komerciale parasheh se “Nëse pala nuk e plotëson cilëndo kërkesë për ndërmarrjen e veprimit brenda periudhës së paraparë në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 apo me këtë Urdhëresë administrative, kryesuesi i Komisionit apo kryetari i trupit gjykues për rastin e ankesës mund t’ia lejojnë palës që të plotësojë atë kërkesë jashtë periudhës së paraparë kohore, nëse ai konsideron se ekzistojnë arsye të justifikueshme për atë mosplotësim të kërkesës, dhe nëse konsideron se asnjë palë tjetër nuk do të përjetojë paragjykim serioz dhe të pariparueshëm nëse pala që nuk e ka plotësuar kërkesën lejohet që të njëjtën ta plotësojë jashtë periudhës së lejuar kohore”.

18. Gjykata e konsideron si të afatshme ankesën për arsye se pala ka paraqitur dokumentacion që dëshmon se sëmundja e tij nuk ka mundur të parashikohen e as të evitohet dhe procedura kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprim.

Meritat e Ankesës

15. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme ka vërejtur se ankesa është e pabazuar.
16. Vendimi i KKKP-së është i drejtë. Gjykata nuk gjen as vërtetimin jo të plotë të fakteve e as zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
17. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t’i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
18. Nuk është e kontestueshme ndërmjet palëve se pala ankuese, apo familja e tij, fillimisht e kishin humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të rrethanave që rezultuan nga konflikti i armatosur.
19. Megjithatë, pala ankuese ishte kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së me datën 31 korrik 2013 dhe 4 shtator 2013 në lidhje me faktin se në regjistrat kadastral prona e kërkuar është gjetur në emër të personave të tretë si bashkëpronarë dhe se shitja si dhe ndarja fizike e pronave të kërkuara kishte ndodhur në bazë të autorizimit të dhënë nga

pala ankuese. Pala ankuese kishte konfirmuar se pronat ishin shitur ne baze te autorizimit që ai i kishte dhënë T. B..

20. Ankesa e S. përsëritë pretendimet e njëjta që ai i kishte bërë para KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është dorëzuar me ankesën.
21. Në vendimin e Komisionit në pikën 27 sqarohet se edhe përkundër pretendimeve të paraqitësit të kërkesës se prona është humbur si pasojë e konfliktit e jo si rezultat i shitjes përmes kontratës, tashmë ngastra nr. 4455 është ndarë në tri parcela 4455/1, 4455/2 që është e evidentuar në emër të pronarëve të rinj bazuar në kontratën Vr.Nr.273/2007 kurse ngastra nr. 4455/3 me sipërfaqe prej 01.42.54 ha evidentohet si pronë shoqërore e Kombinatit Bujqësor “Ereniku”.
22. Gjykata Supreme konsideron se në bazë të deklaratës së tij, pala ankuese ka dështuar të provojë se kërkesa e tij përshinë rrethana të ndërlidhura apo që rezultojnë nga konflikti gjatë viteve 98-99. Në vazhdim, Gjykata Supreme konsideron se humbja e posedimit ishte rezultat i tjetërsimit vullnetar të kësaj prone duke e shitur pas konfliktit.
23. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 , Gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë ligjore:

24. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike

Sylejman Nuredini, Kryetar e Kolegjit,

Beshir Islami, Gjyqtar

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar e EULEX-it

Sandra Gudaityte , Referent i EULEX-it